

**Forcimi i Menaxhimit Financiar Publik në nivel
vendor në Shqipëri- Projekt i financuar nga SECO**

**RAPORT MBI STATUSIN E VËSHTIRËSISË
FINANCIARE TË NJËSIVE TË QEVERISJES
VENDORE**

VITI 2019

Korrik 2020

Autorët: Ekipi i Projektit “Financat Lokale”

Përmbajtja

Përmbledhje	1
I. Hyrje.....	2
II. Metodologjia dhe Mbledhja e të Dhënave	3
III. Analiza mbi Treguesit e Përgjithshëm të Detyrimeve të Prapambetura të Bashkive.....	4
IV. Analiza e Detajuar mbi Treguesit e Detyrimeve të Prapambetura për Secilën Bashki	15
Bashkia Berat	15
Bashkia Bulqizë	19
Bashkia Cërrik	23
Bashkia Delvinë	26
Bashkia Divjakë	28
Bashkia Dropull	30
Bashkia Elbasan	31
Bashkia Fushë Arrëz	34
Bashkia Gramsh	38
Bashkia Gjirokastrë.....	40
Bashkia Has	44
Bashkia Kamëz	46
Bashkia Këlcyrë.....	48
Bashkia Klos	51
Bashkia Korçë.....	53
Bashkia Krujë.....	55
Bashkia Kuçovë	57
Bashkia Kukës	59
Bashkia Kurbin	63
Bashkia Lezhë.....	65
Bashkia Libohovë	67
Bashkia Librazhd	69
Bashkia Lushnjë.....	72
Bashkia Maliq	74



Bashkia Mallakastër.....	78
Bashkia Mat	80
Bashkia Memaliaj	82
Bashkia Mirditë.....	84
Bashkia Patos	86
Bashkia Peqin.....	88
Bashkia Përmet	90
Bashkia Pogradec.....	92
Bashkia Poliçan.....	94
Bashkia Prrenjas.....	96
Bashkia Pukë.....	100
Bashkia Roskovec	102
Bashkia Sarandë.....	104
Bashkia Selenicë	108
Bashkia Skrapar	110
Bashkia Shkodër	112
Bashkia Tepelenë.....	116
Bashkia Tropojë.....	118
Bashkia Ura Vajgurore	120
Bashkia Vau i Dejës.....	122
Bashkia Vlorë.....	124
V. Konkluzione.....	126

Lista e Tabelave

Tabela nr. 1 Rastet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore me vështirësi financiare	2
Tabela nr. 2 Statusi i vështirësisë financiare për NJQV dhjetor 2019	4
Tabela nr. 3 Struktura e detyrimeve të prapambetura dhe detyrimet e akumuluar pas vitit 2015	9
Tabela nr. 4 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Berat, Dhjetor 2019	15
Tabela nr. 5 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Berat, Nëntor 2019 (në lekë).....	16
Tabela nr. 6 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Berat, para dhe pas vitit 2015 (në lekë)	18
Tabela nr. 7 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Bulqizë, Dhjetor 2019.....	19
Tabela nr. 8 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Bulqizë, Nëntor 2019 (në lekë).....	19
Tabela nr. 9 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Bulqizë para dhe pas vitit 2015 (në lekë).....	22
Tabela nr. 10 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Cërrik, Dhjetor 2019	23
Tabela nr. 11 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Cërrik, Nëntor 2019 (në lekë)	23
Tabela nr. 12 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Cërrik para dhe pas vitit 2015 (në lekë).....	25
Tabela nr. 13 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Delvinë, Dhjetor 2019	26
Tabela nr. 14 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Delvinë, Nëntor 2019 (në lekë).....	26
Tabela nr. 15 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Divjakë, Dhjetor 2019	28
Tabela nr. 16 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Divjakë, Nëntor 2019 (në lekë).....	28
Tabela nr. 17 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Elbasan, Dhjetor 2019.....	31
Tabela nr. 18 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Elbasan, Nëntor 2019 (në lekë).....	31
Tabela nr. 19 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Elbasan, para dhe pas vitit 2015 (në lekë)	33
Tabela nr. 20 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Fushë Arrëz, Dhjetor 2019.....	34
Tabela nr. 21 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Fushë Arrëz, Nëntor 2019 (në lekë).....	34
Tabela nr. 22 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Fushë Arrëz, para dhe pas vitit 2015 (në lekë)	37
Tabela nr. 23 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Gramsh, Dhjetor 2019.....	38
Tabela nr. 24 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Gramsh, Nëntor 2019 (në lekë).....	38
Tabela nr. 25 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Gjirokastër, Dhjetor 2019	40
Tabela nr. 26 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Gjirokastër, Nëntor 2019 (në lekë)	40
Tabela nr. 27 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Gjirokastër, para dhe pas vitit 2015 (në lekë)	43
Tabela nr. 28 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Has, Dhjetor 2019.....	44
Tabela nr. 29 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Has, Nëntor 2019 (në lekë)	44
Tabela nr. 30 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Kamëz, Dhjetor 2019.....	46
Tabela nr. 31 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Kamëz, Nëntor 2019 (në lekë)	46
Tabela nr. 32 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Këlcyrë, Dhjetor 2019	48
Tabela nr. 33 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Këlcyrë, Nëntor 2019 (në lekë).....	48
Tabela nr. 34 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Këlcyrë, para dhe pas vitit 2015 (në lekë)	50
Tabela nr. 35 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Klos, Dhjetor 2019.....	51
Tabela nr. 36 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Klos, Nëntor 2019 (në lekë).....	51
Tabela nr. 37 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Korçë, Dhjetor 2019	53
Tabela nr. 38 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Korçë, Nëntor 2019 (në lekë)	53
Tabela nr. 39 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Krujë, Dhjetor 2019	55
Tabela nr. 40 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Krujë, Nëntor 2019 (në lekë)	55
Tabela nr. 41 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Kuçovë, dhjetor 2019.....	57
Tabela nr. 42 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Kuçovë, Nëntor 2019 (në lekë).....	57
Tabela nr. 43 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Kukës, Dhjetor 2019	59
Tabela nr. 44 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Kukës, Nëntor 2019 (në lekë)	59
Tabela nr. 45 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Kukës, para dhe pas vitit 2015 (në lekë).....	62
Tabela nr. 46 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Kurbin, Dhjetor 2019.....	63

Tabela nr. 47 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Kurbin, Nëntor 2019 (në lekë)	63
Tabela nr. 48 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Lezhë, Dhjetor 2019	65
Tabela nr. 49 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Lezhë, Nëntor 2019 (në lekë)	65
Tabela nr. 50 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Libohovë, Dhjetor 2019	68
Tabela nr. 51 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Libohovë, Nëntor 2019 (në lekë)	68
Tabela nr. 52 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Librazhd, Dhjetor 2019	70
Tabela nr. 53 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Librazhd, Nëntor 2019 (në lekë)	70
Tabela nr. 54 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Lushnjë, Dhjetor 2019	72
Tabela nr. 55 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Lushnjë, Nëntor 2019 (në lekë)	72
Tabela nr. 56 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Maliq, Dhjetor 2019	74
Tabela nr. 57 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Maliq, Nëntor 2019 (në lekë)	74
Tabela nr. 58 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Maliq para dhe pas vitit 2015 (në lekë)	77
Tabela nr. 59 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Mallakastër, Dhjetor 2019	78
Tabela nr. 60 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Mallakastër, Nëntor 2019 (në lekë)	78
Tabela nr. 61 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Mat, Dhjetor 2019	80
Tabela nr. 62 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Mat, Nëntor 2019 (në lekë)	80
Tabela nr. 63 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Memaliaj, Dhjetor 2019	82
Tabela nr. 64 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Memaliaj, Nëntor 2019 (në lekë)	82
Tabela nr. 65 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Mirditë, Dhjetor 2019	84
Tabela nr. 66 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Mirditë, Nëntor 2019 (në lekë)	84
Tabela nr. 67 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Peqin, Dhjetor 2019	88
Tabela nr. 68 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Peqin, Nëntor 2019 (në lekë)	88
Tabela nr. 69 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Përmet, Dhjetor 2019	90
Tabela nr. 70 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Përmet, Nëntor 2019 (në lekë)	90
Tabela nr. 71 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Pogradec, Dhjetor 2019	93
Tabela nr. 72 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Pogradec, Nëntor 2019 (në lekë)	93
Tabela nr. 73 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Poliçan, Dhjetor 2019	95
Tabela nr. 74 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Poliçan, Nëntor 2019 (në lekë)	95
Tabela nr. 75 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Prrenjas, Dhjetor 2019	97
Tabela nr. 76 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Prrenjas, Nëntor 2019 (në lekë)	97
Tabela nr. 77 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Prrenjas para dhe pas vitit 2015 (në lekë)	99
Tabela nr. 78 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Pukë, Dhjetor 2019	100
Tabela nr. 79 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Pukë, Nëntor 2019 (në lekë)	100
Tabela nr. 80 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Roskovec, Dhjetor 2019	102
Tabela nr. 81 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Roskovec, Nëntor 2019 (në lekë)	102
Tabela nr. 82 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Sarandë, Dhjetor 2019	104
Tabela nr. 83 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Sarandë, Nëntor 2019 (në lekë)	104
Tabela nr. 84 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Sarandë para dhe pas vitit 2015 (në lekë)	107
Tabela nr. 85 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Selenicë, Dhjetor 2019	108
Tabela nr. 86 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Selenicë, Nëntor 2019 (në lekë)	108
Tabela nr. 87 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Skrapar, Dhjetor 2019	110
Tabela nr. 88 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Skrapar, Nëntor 2019 (në lekë)	110
Tabela nr. 89 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Shkodër, Dhjetor 2019	113
Tabela nr. 90 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Shkodër, Nëntor 2019 (në lekë)	113
Tabela nr. 91 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Shkodër para dhe pas vitit 2015 (në lekë)	115
Tabela nr. 92 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Tepelenë, Dhjetor 2019	116
Tabela nr. 93 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Tepelenë, Nëntor 2019 (në lekë)	116
Tabela nr. 94 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Tropojë, Dhjetor 2019	118
Tabela nr. 95 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Tropojë, Nëntor 2019 (në lekë)	118
Tabela nr. 96 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Ura Vajguore, Dhjetor 2019	121



Tabela nr. 97 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Ura Vajguore, Nëntor 2019 (në lekë)	121
Tabela nr. 98 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Vau i Dejës, Dhjetor 2019	123
Tabela nr. 99 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Vau i Dejës, Nëntor 2019 (në lekë)	123
Tabela nr. 100 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Vlorë, Dhjetor 2019	125
Tabela nr. 101 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Vlorë, Nëntor 2019 (në lekë)	125

Lista e Grafikëve

Grafiku nr. 1 Detyrimet e prapambetura Dhjetor 2019 në përqindje të shpenzimeve të miratuara 2019	5
Grafiku Nr. 2 Shpenzimet e miratuara 2019 (000 lekë) vs detyrimet e prapambetura Dhjetor 2019 (000 lekë)	7
Grafiku nr. 3 Detyrimet e prapambetura përkundrejt shpenzimeve faktike 2019	12
Grafiku nr. 4 Diferenca mes përqindjes së detyrimeve përkundrejt shpenzimeve të miratuara dhe shpenzimeve faktike 2019	14
Grafiku nr. 5 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Berat, Nëntor 2019.....	16
Grafiku nr. 6 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Berat, pas vitit 2015	17
Grafiku nr. 7 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Bulqizë, Nëntor 2019	20
Grafiku nr. 8 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Bulqizë, pas vitit 2015	20
Grafiku nr. 9 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Cërrik, Nëntor 2019	24
Grafiku nr. 10 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Cërrik, pas vitit 2015	24
Grafiku nr. 11 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Delvinë, Nëntor 2019	27
Grafiku nr. 12 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Divjakë, Nëntor 2019	29
Grafiku nr. 13 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Elbasan, Nëntor 2019.....	32
Grafiku nr. 14 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Elbasan, pas vitit 2015	32
Grafiku nr. 15 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Fushë Arrëz, Nëntor 2019.....	35
Grafiku nr. 16 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Fushë Arrëz, pas vitit 2015	35
Grafiku nr. 17 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Gramsh, Nëntor 2019.....	39
Grafiku nr. 18 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Gjirokastrë, Nëntor 2019	41
Grafiku nr. 19 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Gjirokastrë pas vitit 2015.....	41
Grafiku nr. 20 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Has, Nëntor 2019	45
Grafiku nr. 21 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kamëz, Nëntor 2019	47
Grafiku nr. 22 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Këlcyrë, Nëntor 2019.....	49
Grafiku nr. 23 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Klos, Nëntor 2019.....	52
Grafiku nr. 24 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Korçë, Nëntor 2019.....	54
Grafiku nr. 25 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Krujë, Nëntor 2019	56
Grafiku nr. 26 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kuçovë, Nëntor 2019	58
Grafiku nr. 27 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kukës, Nëntor 2019	60
Grafiku nr. 28 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kukës pas vitit 2015	60
Grafiku nr. 29 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kurbin, Nëntor 2019	64
Grafiku nr. 30 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Lezhë, Nëntor 2019.....	66
Grafiku nr. 31 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Libohovë, Nëntor 2019.....	69
Grafiku nr. 32 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Librazhd, Nëntor 2019	71
Grafiku nr. 33 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Lushnjë, Nëntor 2019	73
Grafiku nr. 34 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Maliq, Nëntor 2019.....	75
Grafiku nr. 35 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Maliq pas vitit 2015	76
Grafiku nr. 36 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Mallakastër, Nëntor 2019.....	79
Grafiku nr. 37 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Mat, Nëntor 2019.....	81
Grafiku nr. 38 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Memaliaj, Nëntor 2019	83
Grafiku nr. 39 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Mirditë, Nëntor 2019	85
Grafiku nr. 40 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Peqin, Nëntor 2019	89
Grafiku nr. 41 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Përmet, Nëntor 2019	91
Grafiku nr. 42 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Pogradec, Nëntor 2019	93
Grafiku nr. 43 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Poliçan, Nëntor 2019	96
Grafiku nr. 44 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Prrrenjas, Nëntor 2019	98
Grafiku nr. 45 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Prrrenjas, pas vitit 2015.....	98



Grafiku nr. 46 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Pukë, Nëntor 2019	101
Grafiku nr. 47 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Roskovec, Nëntor 2019.....	103
Grafiku nr. 48 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Sarandë, Nëntor 2019	105
Grafiku nr. 49 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Sarandë pas vitit 2015.....	106
Grafiku nr. 50 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Selenicë, Nëntor 2019.....	109
Grafiku nr. 51 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Skrapar, Nëntor 2019	111
Grafiku nr. 52 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Shkodër, Nëntor 2019	114
Grafiku nr. 53 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Shkodër pas vitit 2015	114
Grafiku nr. 54 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Tepelenë, Nëntor 2019.....	117
Grafiku nr. 55 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Tropojë, Nëntor 2019.....	119
Grafiku nr. 56 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Ura Vajgurore, Nëntor 2019	121
Grafiku nr. 57 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Vau i Dejës, Nëntor 2019.....	123
Grafiku nr. 58 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Vlorë, Nëntor 2019	125

Përmbledhje

Ky raport është përgatitur në funksion të qëllimit të udhëzimit nr. 27, datë 27.9.2019 “Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e qeverisjes vendore” (neni 2/i) për implementimin e një sistemi monitorimi për të identifikuar njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat përballen me probleme financiare, vështirësi financiare, vështirësi serioze financiare apo paaftësi paguese. Gjetjet kryesore në lidhje me situatën financiare të bashkive për 2019 përfshijnë:

- Stoku i detyrimeve të prapambetura deri në dhjetor 2019 për njësitë e qeverisjes vendore është 8.2 miliardë lekë (8,170,094,350 lekë), ose 11.69% e totalit të shpenzimeve të miratuara nga 61 njësi të qeverisjes vendore.
- Bashkia e Kavajës ka një stok të detyrimeve të prapambetura në nivelin e 85.2% të shpenzimeve të miratuara, duke shënuar një status si e vetmja njësi me vështirësi serioze financiare.
- 9 njësi kanë vështirësi financiare (Konispol, Ura Vajgurore, Kukës, Rrogozhinë, Polican, Dibër, Pogradec, Finiq e Tepelenë), 14 njësi kanë probleme financiare, ndërsa të 37 njësitë e tjera nuk kanë probleme financiare. Përmendim veçanërisht një përformancë të mirë të Bashkive të Shkodrës, Korçës, Fierit, Elbasanit, Durrësit e Tiranës me stok të detyrimeve të prapambetura përkundrajt shpenzimeve të miratuara njëshifror.
- 9 prej 18 bashkive raportojnë të kenë më shumë detyrime të natyrës së shpenzimeve kapitale, ku vihet re Kamza me 97.98% të totalit të detyrimeve. 8 nga 18 bashki kanë më shumë detyrime të natyrës së shpenzimeve korrente, ku vihet re Kukësi me 92.93% të totalit të detyrimeve. Pogradeci është e vetmja bashki që ka detyrimet si vendime gjyqësore më të lartat (62.75%), ndjekur nga Bulqiza (40.64%) dhe Libohova (40.49%). Ndërkohë që Lezha është e vetmja bashki me detyrime të natyrës së huasë afatgjatë me 11.32% të totalit të detyrimeve të saj.
- Në lidhje me një analizë në funksion të mbledhjes së detyrimeve para apo pas vitit të reformës territoriale 2015, nga të dhënat e limituara të vëna në dispozicion, pesë nga shtatë bashki që kanë raportuar kanë akumuluar më shumë detyrime pas vitit 2015. Kamza, Kuçova dhe Selenica kanë akumuluar mbi 90% të detyrimeve pas vitit 2015.

Për hartimin e këtij raporti, Drejtoria e Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë ka mbledhur informacion të posaçëm nga Bashkitë sipas formës tabelare në Aneksin 1 dhe Aneksin 5 të Udhëzimit për stokun dhe strukturën e detyrimeve deri në Nëntor 2019 dhe nga raportet e monitorimit mbi stokun e detyrimeve deri në fund Dhjetori 2019.

Analizat kryhen për herë të parë duke mos mundësuar krahasimin me periudhat e mëparshme. Synohet që ato të shërbejnë si një bazë për krahasimin e statusit të vështirësisë financiare të bashkive mes periudhave të ndryshme të raportimit, sikurse edhe për krahasimin mes bashkive lidhur me ecurinë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në kohë dhe cilësinë e menaxhimit financiar.

Nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga bashkitë konstatohet se është e domosdoshme trajnimi i stafëve për plotësimin saktë të informacionit sipas përcaktimeve në Udhëzim, sikurse mungon plotësisht raportimi nga disa bashki, veçanërisht për ata që rezultojnë me probleme apo vështirësi financiare (Kavajë, Konispol, Rrogozhinë, Dibër, Finiq e Belsh). Gjithashtu, lind e domosdoshme që në vijim të kërkohet informacion përshkrimor nga bashkitë mbi vështirësitë që ata hasin për shlyerjen e detyrimeve dhe shkaqet që cojnë në akumulimin e detyrimeve të reja. Kjo do të mundësonte dhënien e rekomandimeve për një menaxhim më të mirë financiar.

I. Hyrje

Në mbështetje të neneve 57 dhe 59 të ligjit nr. 68, datë 17.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ministri i Financave dhe Ekonomisë lëshoi Udhëzimin nr. 27, datë 27.9.2019 “Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e qeverisjes vendore”. Sipas ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në tabelën nr. 1 pasqyrohen katër nivelet e ndryshme të rasteve të vështirësive financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

TABELA NR. 1 RASTET E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE ME VËSHITRËSI FINANCIARE

Nr	Rastet	Kriteret e Klasifikimit
1	Probleme financiare (Neni 55)	(i) Detyrimet financiare të konstatuara dhe papaguara të NJVQV- së, ndaj palëve të treta përbëjnë 15 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara, në një muaj të caktuar; (ii) Detyrimet financiare të konstatuara dhe të papaguara të NJVQV- së, ndaj palëve të treta tejkalojnë 20 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara në muajin pasues.
2	Vështirësia financiare (Neni 56)	Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi financiare kur vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues të muajit kur tejkalon nivelin prej 20 përqind, dhe vlera e stokut rritet progresivisht mbi nivelin prej 25 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara.
3	Vështirësia serioze financiare (Neni 57)	Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi serioze financiare, kur borxhet afatgjata dhe detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta përbëjnë mbi 80 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara.
4	Papaftësia paguese (Neni 59)	Kur njësia e vetëqeverisjes vendore nuk arrin të zbatojë planin e rehabilitimit financiar dhe / ose shuma e borxheve afatgjata të NJVQV-së dhe detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është më e lartë se 130 përqind e shpenzimeve vjetore të miratuara.

Ky raport përgatitet në funksion të qëllimit të udhëzimit (neni 2/i) për implementimin e nje sistemi monitorimi për të identifikuar njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat përballen me probleme financiare, vështirësi financiare, vështirësi serioze financiare apo paaftesi paguese.

II. Metodologjia dhe Mbledhja e të Dhënave

Për hartimin e këtij raporti, Drejtoria e Financave Vendore ka mbledhur informacion nga Bashkitë sipas formës tabelare në Aneksin 1 dhe Aneksin 5 të Udhëzimit nr. 27, datë 27.9.2019 “Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e qeverisjes vendore”.

Analizat në seksionin 4 për secilën bashki janë të bazuara në informacionin e dorëzuar nga bashkitë në fund të Dhjetorit 2019 për stokun e detyrimeve të prapambetura deri në Nëntor 2019. Informacioni tabelor mundëson kryerjen e disa analizave analitike mbi strukturën e detyrimeve dhe stokun e detyrimeve para dhe pas vitit 2015.

Vlen të theksohet se informacioni nuk është dorëzuar nga 20 bashki dhe për gjashtë prej tyre, informacioni mbi shpenzimet e miratuara ka qenë i gabuar. Gjithashtu, për shumicën e bashkive mungon informacioni sipas Aneksit 5 mbi stokun e detyrimeve para dhe pas 2015 dhe për disa prej tyre informacioni ishte i pasaktë.

Ndërkohë, Ministria e Financave disponon edhe të dhënat mbi stokun e detyrimeve deri në fund Dhjetori 2019 për secilën bashki, por jo në nivel analitik ku të mund të vëzhgoheshe struktura e detyrimeve sipas natyrës së detyrimeve apo stoku i akumuluar para dhe pas 2015. Në bazë të këtyre të dhënave janë kryer analizat në seksionin 3 mbi treguesit e përgjithshëm të detyrimeve të prapambetura të NJQV.

Analizat kryhen për herë të parë duke mos mundësuar krahasimin me periudhat e mëparshme. Synohet që ato të shërbejnë si një bazë për krahasimin e statusit të vështirësisë financiare të bashkive mes periudhave të ndryshme të raportimit, sikurse edhe për krahasimin mes bashkive lidhur me ecurinë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në kohë dhe cilësinë e menaxhimit financiar.

Raporti është përgatitur nga Drejtoria e Financave Vendore me mbështetjen e projektit të financuar nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri, SECO për “Financat Lokale”.

III. Analiza mbi Treguesit e Përgjithshëm të Detyrimeve të Prapambetura të Bashkive

Stoku i detyrimeve të prapambetura deri në dhjetor 2019 për njësitë e qeverisjes vendore është 8.2 miliardë lekë (8,170,094,350 lekë), ose 11.69% e totalit të shpenzimeve të miratuara nga 61 njësi të qeverisjes vendore. Nëse do konsiderojmë treguesin e detyrimeve të prapambetura përkundrejt totalit të shpenzimeve faktike të njërive vendore, stoku i detyrimeve të prapambetura është 14.71%.

Sikurse vihet re në tabelën nr. 2 deri në dhjetor 2019, Bashkia e Kavajës ka një stok të detyrimeve të prapambetura në nivelin e 85.2% të shpenzimeve të miratuara, duke shënuar një status si e vetmja njësi me vështirësi serioze financiare. Nëntë njësi kanë vështirësi financiare, 14 njësi kanë probleme financiare, ndërsa të 37 njësitë e tjera nuk kanë probleme financiare. Përmendim veçanërisht një performancë të mirë të Bashkive të Shkodrës, Korçës, Fierit, Elbasanit, Durrësit e Tiranës me stok të detyrimeve njëshifror.


TABELA NR. 2 STATI I VËSHTIRËSISË FINANCIARE PËR NJQV DHJETOR 2019

Nr.	Njësitë e Qeverisjes Vendore	Përqindja e stokut ndaj shpenzimeve të miratuara	Statusi i Vështirësisë
37	Të gjitha bashkitë që nuk përmenden më poshtë	< 15 %	Pa Probleme Financiare
14	Peqin (PQN)	14.91%	Probleme Financiare
	Belsh (BLSH)	15.25%	
	Lezhë (LZH)	17.26%	
	Kuçovë (KCV)	17.36%	
	Klos (KLS)	18.27%	
	Selenicë (SLN)	18.42%	
	Mirditë (MRD)	19.25%	
	Kamëz (KMZ)	19.97%	
	Cërrik (CRRK)	21.01%	
	Librazhd (LBR)	21.12%	
	Roskovec (RSK)	21.53%	
	Libohovë (LBH)	23.30%	
	Bulqizë (BLQ)	23.49%	
	Tropojë (TRP)	24.44%	
9	Tepelenë (TPL)	31.81%	Vështirësi Financiare
	Finiq (FNQ)	32.79%	
	Pogradec (PGR)	35.89%	
	Dibër (DBR)	37.04%	
	Poliçan (PLC)	41.94%	
	Rrogozhinë (RRGZH)	43.34%	
	Kukës (KKS)	44.13%	
	Ura Vajgurore (URV)	45.82%	
	Konispol (KNS)	58.76%	
1	Kavajë (KVJ)	85.20%	Vështirësi Serioze Financiare

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Grafiku nr.1 pasqyron stokun e detyrimeve të prapambetura për të gjitha bashkitë. Mesatarja e detyrimeve është 16%.

GRAFIKU NR. 1 DETYRIMET E PRAPAMBETURA DHJETOR 2019 NË PËRQINDJE TË SHPENZIMEVE TË MIRATUARA 2019



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë



Grafiku nr. 2 pasqyron pozicionimin e bashkive sipas stokut të detyrimeve të prapambetura përkundrejt totalit të shpenzimeve të miratuara 2019. Bashkia e Tiranës nuk është përfshirë në këtë grafik meqë do të vështirësonte paraqitjen grafike të shumë bashkive të tjera me buxhet shumë herë më të vogël.

GRAFIKU NR. 2 SHPENZIMET E MIRATUARA 2019 (000 LEKË) VS DETYRIMET E PRAPAMBETURA DHJETOR 2019 (000 LEKË)




Tabela nr. 3 pasqyron strukturën e detyrimeve të prapambetura për të gjitha bashkitë me detyrime më të larta se 15% të shpenzimeve të miratuara. Mesatarisht, nga të dhënat e 18 bashkive me probleme apo vështirësi financiare, të cilat kanë raportuar situatën e tyre deri në nëntor 2019 pranë Ministrisë së Financave, 38.44% e detyrimeve janë të natyrës së shpenzimeve korrente, 47.68% të natyrës së shpenzimeve kapitale, 13.08% të natyrës nga vendimet gjyqësore dhe 0.63% hua afatgjatë.

Nëntë prej 18 bashkive raportojnë të kenë më shumë detyrime të natyrës së shpenzimeve kapitale, ku vihet re Kamza me 97.98% të totalit të detyrimeve. Tetë nga 18 bashki kanë më shumë detyrime të natyrës së shpenzimeve korrente, ku vihet re Kukësi me 92.93% të totalit të detyrimeve. Pogradeci është e vetmja bashki që ka detyrimet si vendime gjyqësore më të lartat (62.75%), ndjekur nga Bulqiza (40.64%) dhe Libohova (40.49%). Ndërkohë që Lezha është e vetmja bashki me detyrime të natyrës së huasë afatgjatë me 11.32% të totalit të detyrimeve të saj.

Në lidhje me një analizë në funksion të mbledhjes së detyrimeve para apo pas vitit të reformës territoriale 2015, nga të dhënat e limituara të vëna në dispozicion, pesë nga shtatë bashki që kanë raportuar kanë akumuluar më shumë detyrime pas vitit 2015. Kamza, Kuçova dhe Selenica kanë akumuluar mbi 90% të detyrimeve pas vitit 2015.

TABELA NR. 3 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA DHE DETYRIMET E E AKUMULUARA PAS VITIT 2015

Statusi i Vështirësisë	Bashkia	Përqindja e detyrimeve përkundrejt shpenzimeve të miratuara	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Vendime gjyqësore	Hua sfatgjatë	Detyrimet e prapambetura Pas 2015
Probleme Financiare	Peqin (PQN)	14.91%	86.64%	1.35%	12.00%	0.00%	nuk ka të dhëna
	Belsh (BLSH)	15.25%	Nuk ka të dhëna				
	Lezhë (LZH)	17.26%	54.48%	33.59%	0.61%	11.32%	nuk ka të dhëna
	Kuçovë (KCV)	17.36%	72.04%	20.91%	7.05%	0.00%	97.06%
	Klos (KLS)	18.27%	26.00%	71.36%	2.64%	0.00%	nuk ka të dhëna
	Selenicë (SLN)	18.42%	26.90%	62.04%	11.06%	0.00%	89.59%
	Mirditë (MRD)	19.25%	61.89%	29.71%	8.40%	0.00%	nuk ka të dhëna
	Kamëz (KMZ)	19.97%	0.00%	97.98%	2.02%	0.00%	99.50%
	Cërrik (CRRK)	21.01%	48.49%	46.71%	4.80%	0.00%	të dhëna jo të sakta
	Librazhd (LBR)	21.12%	4.32%	81.12%	14.56%	0.00%	nuk ka të dhëna
	Roskovec (RSK)	21.53%	4.29%	95.36%	0.35%	0.00%	nuk ka të dhëna
	Libohovë (LBH)	23.30%	50.96%	8.55%	40.49%	0.00%	të dhëna jo të sakta
	Bulqizë (BLQ)	23.49%	0.00%	59.36%	40.64%	0.00%	57.89%
	Tropojë (TRP)	24.44%	20.54%	77.85%	1.61%	0.00%	nuk ka të dhëna
Vështirësi Financiare	Tepelenë (TPL)	31.81%	73.66%	20.65%	5.70%	0.00%	nuk ka të dhëna
	Finiq (FNQ)	32.79%	nuk ka të dhëna				
	Pogradec (PGR)	35.89%	18.09%	19.16%	62.75%	0.00%	46.97%
	Dibër (DBR)	37.04%	nuk ka të dhëna				
	Poliçan (PLC)	41.94%	38.21%	49.45%	12.34%	0.00%	nuk ka të dhëna
	Rrogozhinë (RRGZH)	43.34%	nuk ka të dhëna				
	Kukës (KKS)	44.13%	92.93%	0.00%	7.07%	0.00%	66.27%
	Ura Vajgurore (URV)	45.82%	12.44%	86.26%	1.30%	0.00%	10.74%
	Konispol (KNS)	58.76%	nuk ka të dhëna				
Vështirësi Serioze Financiare	Kavajë (KVJ)	85.20%	nuk ka të dhëna				
Mesatarja			38.44%	47.86%	13.08%	0.63%	66.86%




Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë



Nëse do të vlerësonim situatën e detyrimeve të prapambetura të bashkive përkundrejt shpenzimeve faktike të vitit 2019, vihet re një përkeqësim i treguesit të detyrimeve. Grafiku nr. 3 pasqyron rezultatet të cilat duhet të vlerësohen me kujdes nga secila bashki.

GRAFIKU NR. 3 DETYRIMET E PRAPAMBETURA PËRKUNDREJT SHPENZIMEVE FAKTIKE 2019






Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shpenzimet Faktike sipas Raportit Vjetor 2019 mbi Performancën e NJQV

Grafiku nr. 4 pasqyron diferencat mes treguesit të detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve të miratuara dhe atij përkundrejt shpenzimeve faktike 2019. Mesatarja e diferencës është 4% dhe shumica e bashkive shënojnë diferenca të arsyeshme nën mesatare. Shqetësuese është situata për tetë bashki: Konispol, Selenicë, Rrogozhinë, Roskovec, Pogradec, Lezhë, Libohovë e Kavajë të cilat shënojnë diferenca dyshifrore si rezultat i mosrealizimit të buxhetit të tyre.

GRAFIKU NR. 4 DIFERENCA MES PËRQINDJES SË DETYRIMEVE PËRKUNDREJT SHPENZIMEVE TË MIRATUARA DHE SHPENZIMEVE FAKTIKE 2019



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shpenzimet Faktike sipas Raportit Vjetor 2019 mbi Performancën e NJQV

IV. Analiza e Detajuar mbi Treguesit e Detyrimeve të Prapambetura për Secilën Bashki

Bashkia Berat

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2019 janë 12.8% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Beratit, më pak se 15% duke dëshmuar për një situatë pa probleme financiare. Situata është nën mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (16%) dhe pak mbi treguesin e totalit të njërive vendore (11.69%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2019, detyrimet e prapambetura janë 16.47% (Tabela nr.4).

TABELA NR. 4 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË BERAT, DHJETOR 2019

	Detyrime të prapambetura	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2019	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara	Totali i Shpenzimeve Faktike 2019	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike
Bashkia Berat	148,895,137	1,163,759,532	12.8%	903,811,966	16.47%
Totali NJV	8,170,094,350	69,884,229,000	11.69%	55,550,234,320	14.71%
Mesatarja NJV			16.0%		20.01%

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sipas raportimi deri në nëntor, detyrimet shënonin 14.13% të shpenzimeve totale të miratuara (165 milionë lekë) (Tabela nr. 5). Në fund të dhjetorit, një pjesë e stokut të detyrimeve është shlyer duke arritur në nivelin e 149 milionë lekë, dhe treguesi i stokut përkundrejt shpenzimeve totale të miratuara është reduktuar në 12.8%.


TABELA NR. 5 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË BERAT, NËNTOR 2019 (NË LEKË)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	164,476,329		
a	Shpenzime korrente	72,836,641		
a.1	Mallra dhe shërbime	67,916,903	1,163,759,532	14.13%
a.2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera	4,919,738		
b	Shpenzime kapitale	72,915,671		
b.1	Institucione buxhetore			
b.2	Subjekte private	72,915,671		
c	Vendime gjyqësore	18,724,017		
c.1	Marrëdhënie pune	11,460,421		
c.2	Mallra dhe shërbime			
c.3	Investime	1,039,008		
c.4	Të tjera	6,224,588		
III	Totali (I+II)	164,476,329		

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Grafiku nr.5 pasqyron strukturën e detyrimeve të prapambetura nëntor 2019, ku ato për shpenzimet kapitale janë disi më të larta se ato në shpenzimet korrente respektivisht 44.33% dhe 44.28%. Detyrimet për vendimet gjyqësore përbëjnë 11.38% dhe detyrimet për hua afatgjata apo afatshkurtra janë 0%.

GRAFIKU NR. 5 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË BERAT, NËNTOR 2019




Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Në funksion të një analize më të thelluar të detyrimeve të prapambetura, pas vitit 2015 rreth 97% e detyrimeve të prapambetura janë shpenzime korrente të natyrës së mallrave dhe shërbimeve, 3.3% janë

shpenzime kapitale si detyrime ndaj subjekteve private dhe asnjë detyrim i natyrës së vendimeve gjyqësore (Grafiku nr. 6).

GRAFIKU NR. 6 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË BERAT, PAS VITIT 2015



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Ndërkohë, me rëndësi është të përmendim se Bashkia Berat para vitit 2015 nuk kishte asnjë detyrim të prapambetur. Tabela nr. 6 pasqyron në mënyrë të detajuar detyrimet e prapambetura para dhe pas vitit 2015.

TABELA NR. 6 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË BERAT, PARA DHE PAS VITIT 2015 (NË LEKË)

Nr	Emërtimi	Stoku në vlerë i detyrimeve me probleme	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku në % ndaj shpenzimeve totale	Para 2015			Pas 2015		
					Detyrime të konstatuara me probleme në dokumentacion	Detyrime të pa regjistruara në kontabilitetin e NJVQV-së	Detyrime të konstatuara me probleme të tjera	Detyrime të konstatuara me probleme në dokumentacion	Detyrime të pa regjistruara në kontabilitetin e NJVQV-së	Detyrime të konstatuara me probleme të tjera
		1=4+5+6+7+8+9	2	3=1/2	4	5	6	7	8	9
	Shpenzime Korrente	995,850.00	1,163,759,532.00	0.086%	0.00	0.00	0.00	995,850.00	0.00	0.00
a	Mallra dhe shërbime	995,850.00		0.086%				995,850.00		
b	Paga dhe sigurime	0.00								
c	Të tjera	0.00								
	Shpenzime Kapitale	34,440.00		0.003%	0.00	0.00	0.00	34,440.00	0.00	0.00
a	Institucione buxhetore	0.00								
b	Subjekte private	34,440.00		0.296%				34,440.00		
	Vendime Gjyqësore	0.00		0.000%	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
a	Marrëdhënie pune	0.00		0.000%						
b	Mallra dhe shërbime	0.00		0.000%						
c	Investime	0.00		0.000%						
d	Të tjera	0.00		0.000%						
	TOTALI	1,030,290.00			0.089%	-	-	-	1,030,290.00	-

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Bashkia Bulqizë

Detyrimet e prapambetura për periudhën deri në dhjetor 2019 janë 23.5% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Bulqizës, nën 25% duke dëshmuar për një situatë me probleme financiare. Situata është mbi mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (16%) dhe mbi treguesin e totalit të njësive vendore (11.69%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2019, detyrimet e prapambetura janë 26.08% (Tabela nr. 7).

TABELA NR. 7 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË BULQIZË, DHJETOR 2019

Bashkia	Detyrime të prapambetura	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2019	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara	Totali i Shpenzimeve Faktike 2019	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike
Bashkia Bulqizë	150,213,152	639,536,000	23.5%	575,939,960	26.08%
Totali NJV	8,170,094,350	69,884,229,000	11.69%	55,550,234,320	14.71%
Mesatarja NJV			16.0%		20.01%

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sipas raportimit deri në nëntor, detyrimet shënonin vetëm 4.12% të shpenzimeve totale të miratuara (26 milionë lekë) (Tabela nr. 8). Në fund të dhjetorit, situata është përkeqësuar duke akumuluar 150 milionë detyrime në total, në 23.5% të shpenzimeve të miratuara.


TABELA NR. 8 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË BULQIZË, NËNTOR 2019 (NË LEKË)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së		
I	Borxhe (a+b)	0				
a	Hua sftatgjatë	0				
a.1	Principali					
a.2	Interesi					
b	Hua afatshkurtër	0				
b.1	Hua					
b.2	Overdrafte					
b.3	Kredi të furnitorëve					
II	Detyrime (a+b+c)	26,369,447				
a	Shpenzime korrente	48,000				
a.1	Mallra dhe shërbime	48000	639,536,000	4.12%		
a.2	Paga dhe sigurime					
a.3	Të tjera					
b	Shpenzime kapitale	20,117,581				
b.1	Institucione buxhetore	20117581				
b.2	Subjekte private					
c	Vendime gjyqësore	6,203,866				
c.1	Marrëdhënie pune	2026300				
c.2	Mallra dhe shërbime					
c.3	Investime	4177566				
c.4	Të tjera					
III	Totali (I+II)	26,369,447				

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Grafiku nr. 7 pasqyron strukturën e detyrimeve të prapambetura deri në nëntor 2019, ku ato për shpenzimet kapitale janë më të larta me 76.29% dhe shpenzimet për vendimet gjyqësore janë 23.53%. Detyrimet shpenzime korrente përbëjnë 0.18% dhe detyrimet për hua afatgjata apo afatshkurtra janë 0%.


GRAFIKU NR. 7 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË BULQIZË, NËNTOR 2019



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Në funksion të një analize më të thelluar të detyrimeve të prapambetura, pas vitit 2015 është akumuluar rreth 57.9% e stokut total të detyrimeve. Rreth 59.36% e detyrimeve të prapambetura janë shpenzime kapitale dhe 40.64% janë detyrime të natyrës së vendimeve gjyqësore (Grafiku nr. 8).

GRAFIKU NR. 8 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË BULQIZË, PAS VITIT 2015



Burimi: Raportimet e Bashkisë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë



Para vitit 2015 është akumuluar 42.1% e stokut total të detyrimeve. Tabela nr. 9 pasqyron në mënyrë të detajuar detyrimet e prapambetura para dhe pas vitit 2015.

TABELA NR. 9 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË BULQIZË PARA DHE PAS VITIT 2015 (NË LEKË)

Nr	Emërtimi	Stoku në vlerë i detyrimeve me probleme	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku në % ndaj shpenzimeve totale	Para 2015			Pas 2015		
					Detyrime të konstatuara me probleme në dokumentacion	Detyrime të pa regjistruara në kontabilitetin e NJVQV-së	Detyrime të konstatuara me probleme të tjera	Detyrime të konstatuara me probleme në dokumentacion	Detyrime të pa regjistruara në kontabilitetin e NJVQV-së	Detyrime të konstatuara me probleme të tjera
		1=4+5+6+7+8+9	2	3=1/2	4	5	6	7	8	9
Shpenzime Korrente		48,000	639,536,000	0.01%	48,000	0	0	0	0	0
a	Mallra dhe	48,000		0.01%	48,000					
b	Paga dhe sig	0		0.00%						
c	Të tjera	0		0.00%						
Shpenzime Kapitale		20,117,581		3.15%	1,558,922	0	9,498,497	9,060,162	0	0
a	Insitucione	20,117,581		3.15%	1,558,922		9,498,497	9,060,162		
b	Subjekte pri	0		0.00%						
Vendime Gjyqësore		6,203,866		0.97%	0	0	0	0	0	6,203,866
a	Marrëdhëni	2,026,300		0.32%						2,026,300
b	Mallra dhe	0		0.00%						
c	Investime	4,177,566		0.65%						4,177,566
d	Të tjera	0		0.00%						
TOTALI		26,369,447			4.12%	1,606,922	0	9,498,497	9,060,162	0

Burimi: Raportimet e Bashkisë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Bashkia Cërrik

Detyrimet e prapambetura deri në 2019 janë 21% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Cërrikut, më shumë se 15% duke dëshmuar për një situatë me probleme financiare. Situata është mbi mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (16%) dhe mbi treguesin e totalit të njërive vendore (11.69%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2019, detyrimet e prapambetura janë 22.49% (Tabela nr. 10).

TABELA NR. 10 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË CËRRIK, DHJETOR 2019

Bashkia	Detyrime të prapambetura	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2019	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara	Totali i Shpenzimeve Faktike 2019	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike
Bashkia Cërrik	78,615,798	374,261,614	21.0%	349,519,358	22.49%
Totali NJV	8,170,094,350	69,884,229,000	11.69%	55,550,234,320	14.71%
Mesatarja NJV			16.0%		20.01%

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sipas raportimit deri në nëntor, detyrimet shënonin 21.01% (79 milionë lekë) të shpenzimeve totale të miratuara (Tabela nr. 11). Në fund të dhjetorit, situata nuk ka ndryshuar si në vlerë absolute të detyrimeve, ashtu edhe në përqindje ndaj totalit të shpenzimeve faktike.


TABELA NR. 11 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË CËRRIK, NËNTOR 2019 (NË LEKË)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sftatgjatë	0		
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	78,615,798		
a	Shpenzime korrente	38,122,884		
a.1	Mallra dhe shërbime	16,634,718	374,261,614	21.01%
a.2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera	21,488,166		
b	Shpenzime kapitale	36,717,746		
b.1	Institucione buxhetore			
b.2	Subjekte private	36,717,746		
c	Vendime gjyqësore	3,775,168		
c.1	Marrëdhënie pune	3,349,168		
c.2	Mallra dhe shërbime			
c.3	Investime			
c.4	Të tjera	426,000		
III	Totali (I+II)	78,615,798		

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Grafiku nr. 9 pasqyron strukturën e detyrimeve të prapambetura deri në nëntor 2019, ku ato për shpenzimet kapitale janë pak më të larta se shpenzimet korrente, respektivisht 48.49% dhe 46.71%. Detyrimet për vendimet gjyqësore përbëjnë 4.8% dhe detyrimet për hua afatgjata apo afatshkurtra janë 0%.


GRAFIKU NR. 9 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË ÇËRRIK, NËNTOR 2019



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Në funksion të një analize më të thelluar të detyrimeve të prapambetura, pas vitit 2015 është akumuluar vetëm 0.7% e stokut total të detyrimeve. Të gjitha detyrimet janë të natyrës së vendimeve gjyqësore (Grafiku nr. 10).

GRAFIKU NR. 10 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË ÇËRRIK, PAS VITIT 2015



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2019 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Para vitit 2015 është akumuluar 99.3% e stokut total të detyrimeve. Tabela nr. 12 pasqyron në mënyrë të detajuar detyrimet e prapambetura para dhe pas vitit 2015.

TABELA NR. 12 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË ÇËRRIK PARA DHE PAS VITIT 2015 (NË LEKË)

Nr	Emërtimi	Stoku në vlerë i detyrimeve me probleme	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku në % ndaj shpenzimeve totale	Para 2015			Pas 2015			
					Detyrime të konstatuara me probleme në dokumentacion	Detyrime të pa regjistruara në kontabilitetin e NJVQV-së	Detyrime të konstatuara me probleme të tjera	Detyrime të konstatuara me probleme në dokumentacion	Detyrime të pa regjistruara në kontabilitetin e NJVQV-së	Detyrime të konstatuara me probleme të tjera	
		1=4+5+6+7+8+9	2	3=1/2	4	5	6	7	8	9	
Shpenzime Korrente		0	374,261,614	0.00%	0	0	0	0	0	0	
a	Mallra dhe shërbime	0		0.00%							
b	Paga dhe sigurime	0		0.00%							
c	Të tjera	0		0.00%							
